



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, neni 4 Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimi të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, si dhe nenin 17 paragrafi 3 i Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/2020, pas shqyrtimit të ankesës së OE-ve: “HORN & CO.KOSOVA” SH.P.K & “COMPANY MURSELI” SH.P.K -Deçan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rrënimi –Ekzekutimi i objekteve pa leje ndërtimi-ilegale dhe shërbime të tjera” me nr të prok: 632-20-1610-5-2-1 iniciuar nga AK/ – “Kuvendi Komunal Gjakovë”, Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit me datën: 11.12.2020 mori këtë :

VENDIM

- I. **Hedhet si e pa Lejuar** ankesa e OE-ve: “HORN & CO.KOSOVA” SH.P.K & “COMPANY MURSELI” SH.P.K -Deçan, me nr. të protokollit. 1071/20, e datës: 09 DHEJTOR 2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Rrënimi –Ekzekutimi i objekteve pa leje ndërtimi-ilegale dhe shërbime të tjera” me nr të prok: 632-20-1610-5-2-1 iniciuar nga AK/ – “Kuvendi Komunal Gjakovë”.
- II. **I LEJOHET** Autoritetit Kontraktues –AK// “Kuvendi Komunal Gjakovë”, që të vazhdoj më tutje me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Rrënimi –Ekzekutimi i objekteve pa leje ndërtimi-ilegale dhe shërbime të tjera” me nr të prok: 632-20-1610-5-2-1 iniciuar nga AK/ – “Kuvendi Komunal Gjakovë”, përkitazi me këtë ankesë,(nëse nuk ka ankesë tjetër).
- III. Ankesa e Operatorit Ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta nuk është proceduar sipas nenit 1 të LPP-së dhe sipas nenit 108/A të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteti Kontraktues, parashtrimi të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave,operatorit ekonomik ankues sipas nenit 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, i kthehet tarifa e ankesës.

IV. **Obligohet**, OE ankues që konform nenit 31 pika 6-të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Më datën 09 DHJETOR 2020, Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik ka pranuar ankesën e parashtruar nga ana OE-ve: "HORN & CO.KOSOVA" SH.P.K & "COMPANY MURSELI" SH.P.K -Deçan, e cila ankesë protokollohet me nr. të protokollit: 1071/20, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rrënimi –Ekzekutimi i objekteve pa leje ndërtimi-ilegale dhe shërbime të tjera" me nr te prok: 632-20-1610-5-2-1 iniciuar nga AK/ – "Kuvendi Komunal Gjakovë" .

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka analizuar ankesën e parashtruar nga Operatorë Ekonomik: "HORN & CO.KOSOVA" SH.P.K & "COMPANY MURSELI" SH.P.K -Deçan me nr. të protokollit: 1071/20, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Rrënimi –Ekzekutimi i objekteve pa leje ndërtimi-ilegale dhe shërbime të tjera" me nr te prok: 632-20-1610-5-2-1 iniciuar nga AK/ – "Kuvendi Komunal Gjakovë", bazuar në verifikimin e shkresave të lëndës si duke u bazuar në nenin 1 dhe nenin 108/A të LPP-së Sqaron.

Nga se Autoriteti Kontraktues (AK) "Kuvendi Komunal Gjakovë", për aktivitetin e prokurimit "Rrënimi – Ekzekutimi i objekteve pa leje ndërtimi-ilegale dhe shërbime të tjera" me nr te prok: 632-20-1610-5-2-1 iniciuar nga AK/ – "Kuvendi Komunal Gjakovë", Njoftimi mbi Vendimin e AK-së është me datën 08.12.2020, Operatorët Ekonomik kanë parashtruar Ankesë në OSHP në Kundërshtim me nenin 1 dhe nenin 108/A të LPP-së, Ngase sipas këtij neni rregullat për paraqitje të kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese,parashtrim të Ankesave në OSHP dhe vlera e tarifave të Ankesave e që Fillimisht Kërkesa për Rishqyrtim nga palët e interesuara parashtrohet tek Autoriteti Kontraktues i cili udhëheq Aktivitetin e Prokurimit dhe është Obligim të respektohen afatet ligjore sipas LPP-së. Operatorët Ekonomik kanë parashtruar ankesë në OSHP më date 09.12.2020.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton Operatorët Ekonomik: "HORN & CO.KOSOVA" SH.P.K & "COMPANY MURSELI" SH.P.K -Deçan, se ankesa e OE-ve është parashtruar dhe cilësohet si e palejuar sepse e njëjta nuk është proceduar sipas nenit 108/A të LPP-së si dhe nenin 1 të Rregullave e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteti Kontraktues, parashtrimi të ankesave pranë OSHP-së andaj ankesa e datës 09.12.2020 me numër të protokollit 1071/20, nuk mund të shqyrtohet nga OSHP dhe e njëjta hedhet si

e pa Lejuar.

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se neni 5 i LPP-së specifikon :

Kalkulimi i afateve kohore

1. Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit.

Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të diele ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj.

Organi shqyrtues i prokurimit sqaron se neni 1 dhe neni 108/A të Rregullave për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimi të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave specifikon: Ankesa pranë OSHP-së:

Kërkesa për rishqyrtim duhet të paraqitet me shkrim dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:

- a). Fillimisht Kërkesa për Rishqyrtim nga palët e interesuara parashtrohet tek Autoriteti Kontraktues i cili udhëheq Aktivitetin e Prokurimit dhe është Obligim të respektohen afatet ligjore sipas LPP-së.
- b). Në rast se pala e interesuar nuk është e kënaqur me vendimin e marr nga Autoriteti Kontraktues në fjalë, mund të **Parashtroj ankese pranë OSHP-se.**

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se neni 9 paragrafi 1 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimi të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave specifikon: Ankesa pranë OSHP-së, duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-së.

Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lartë OSHP konstaton se ankesa e parashtruar në OSHP të OE-ve: "HORN & CO.KOSOVA" SH.P.K & "COMPANY MURSELI" SH.P.K -Deçan, e datës 09.12.2020 me numër të Protokollit 1071/20, hedhet si pa Lejuar sepse ankuesi ka parashtruar ankesë në OSHP në kundërshtim me nenin 1 dhe neni 108/A të Rregullave për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimi të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, andaj e njëjta ankesë hedhet si e pa Lejuar dhe nuk hyn në shqyrtim nga OSHP. Gjithashtu, Sipas paragrafit 1 të nenit 111 të LPP-së, çdo palë e interesuar mund të dorëzojë një ankesë në OSHP, sidoqoftë, OSHP do të marrë masa vetëm nëse ankesa e tillë i plotëson kërkesat e përcaktuara decidivisht me këtë nen.

Se çka konsiderohet "Palë e interesuar", është dhënë përkufizimi në paragrafin 1, nën paragrafin 1.26 të nenit 4 të LPP-së si në vijim, citoj:

"1.26. Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar".

Kryetari i OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryetari i OSHP-së

Blerim DINA



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- "Kuvendi Komunal Gjakovë"

1x1 OE "HORN & CO.KOSOVA" SH.P.K & "COMPANY MURSELI" SH.P.K -Deçan,

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së